



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**PROGRAMI I TRAJNIMIT**  
**TË VIJUESHËM PROFESIONAL PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM**  
**NË SEKTORIN PUBLIK**  
**PËR VITIN 2020**

HYRJE .....	3
I. PËRMBAJTJA, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT PROFESIONAL .....	5
II. METODOLOGJIA E TRAJNIMIT .....	7
III. VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIM .....	9
IV. VLERËSIMI I BURIMEVE TË TRAJNIMIT .....	12
KATEGORITË E GRUPEVE TË TRAJNIMIT .....	13
CIKLI DHE DREJTUESIT E TRAJNIMIT .....	13
VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PROCESIT TË TRAJNIMIT .....	14
MONITORIMI.....	14
PROGRAMI VJETOR SIPAS MODULEVE TË TRAJNIMIT .....	15
MODULI I PARË I TRAJNIMIT:.....	15
MODULI I DYTË I TRAJNIMIT: .....	17
MODULI I TRETË I TRAJNIMIT: .....	19

## **HYRJE**

Zhvillimet e shpejta dhe kërkesat në rritje për një qeverisje të mirë, me përgjegjshmëri të lartë dhe transparencë të sektorit publik kanë vendosur auditimin e brendshëm gjithashtu nën presion për t'u përshtatur me një mjedis me ndryshim të shpejtë.

Pavarësisht nga reformat e rëndësishme, kërkesa e publikut për më shumë përgjegjësi dhe administrim më të mirë të burimeve publike mbetet një “kurbë” në rritje, një sfidë që mbart shumë rrisje dhe që kërkon ndërmarrjen e veprimeve dhe iniciativave të reja që të mundësojnë përmbushjen e pritshmërive të publikut në lidhje me përdorimin e fondeve të taksapaguesve.

Auditimi i brendshëm luan një rol të rëndësishëm në këto zhvillime dhe për më tepër duhet të jetë një mbështetës i vlefshëm për t'iu përgjigjur kërkesave dhe sfidave që sjell zhvillimi dhe ndryshimi.

Si pjesë integrale e menaxhimit financiar të qeverisjes dhe si një instrument efektiv për përmirësimin e performancës në sektorin publik, kërkesa për përgjegjshmëri të lartë dhe transparencë më të madhe brenda qeverisjes ka rritur nevojën për më shumë informacion rreth programeve dhe shërbimeve publike, për më shumë profesionalizëm në përmbushjen e misionit të auditimit të brendshëm, për të sjellë vlerë të shtuar. Si rrjedhojë, kjo do të sjellë dhe interes më të rritur dhe ndërgjegjësim nga ana e titullarëve për vlerën e këtij funksioni, rolin dhe shërbimet që auditimi i brendshëm mund t'i sjellë drejtimit të institucionit dhe qeverisjes publike në përgjithësi.

Zhvillimet në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar vendosin para auditimit të brendshëm pritshmëri dhe kërkesa mjaft të larta të cilat shkojnë në “një hap” me zhvillimin e njësisë të sektorit publik ku strukturat e auditimit të brendshëm janë ngritur e funksionojnë. Këto kushte kërkojnë që në përmbushje të misionit të tij si një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike, auditimi i brendshëm duhet të formojë, ruajë dhe zhvillojë vlerat dhe aftësitë profesionale, duke siguruar që në çdo rast veprimtaria audituese të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të pranuar.

Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i realizuar nëpërmjet certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm si pjesë e skemave të zhvillimit profesional të stafit, mbetet një nga detyrat kryesore të cilësuara dhe në misionin e Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Përpjekjet në këtë drejtim kanë synuar përmbushjen e kërkesave të standardeve po ashtu dhe kuadrit ligjor e nënligjor që mbështet veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Sistemi i krijuar ka synuar dhe kërkon të arrijë në vazhdimësi të sigurojë që audituesit e brendshëm të kenë kapacitetet e nevojshme dhe të zotërojnë aftësi profesionale dhe etike të tilla që të bëjnë të mundur të përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të kryejnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të IIA-së për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm si kërkesë thelbësore të misionit.

Standardet e Auditimit të Brendshëm kërkojnë që: “...*Audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë njohuri, aftësi dhe zotësi të tjera të nevojshme, për të përmbushur përgjegjësitë individuale. Aktiviteti i auditimit të brendshëm bashkërisht duhet të zotërojë ose të fitojë njohuritë, aftësitë dhe zotësitë e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë përkatëse...*”

Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm në sektorin publik ka si qëllim që nëpërmjet përditësimit të njohurive në fushën e auditimit të brendshëm, përshtatjes së aftësive të audituesve me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të përparuara të punës të sigurojnë ofrimin e një shërbimi auditimi sa më cilësor, si dhe adresimin e përmirësimeve të nevojshme me anë të komunikimit të rezultateve për çdo angazhim auditimi të kryer në njësinë publike ku ata zhvillojnë këtë veprimtari.

#### 1230 – Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

*Audituesit e brendshëm duhet të zgjerojnë njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tjera të tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.*

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB) bazuar në nenin 20, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, zhvillon çdo vit Program për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm të punësuar në sektorin publik, i cili promovon shkëmbimin e eksperiencave dhe përditësimin e njohurive lidhur me përcaktimet në bazën ligjore rregullatore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar.

Edhe pse bazat e zhvillimit të kapaciteteve të auditimit të brendshëm kanë një histori zhvillimi disavjecare, trajnimi i vijueshëm profesional për vitin 2019 paraqet një mënyrë të përmirësuar të të punuarit dhe evoluimit të profesionit më strategjike, elastike, si pjesë integrale e zhvillimit të përgjithshëm strategjik si dhe më të aftë për t’iu përgjigjur pritshmërive ndaj auditimit të brendshëm publik.

Programi i zhvillimit profesional synon të ndërtojë kapacitetet e nevojshme audituese për të qenë aktorë efektivë dhe që t’i përgjigjen me sukses sfidave aktuale dhe të reja.

Ruajtja e kompetencës profesionale, kur audituesve iu duhet të përballen me sfida të mëdha, nxjerr si kërkesë të domosdoshme që vetë audituesit të krijojnë dhe mbajnë një qasje të “*krijimit të kulturës së të mësuarit*”.

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve duhet të sigurojnë një bazë të njohurive, aftësive dhe vlerave profesionale, e cila u mundëson atyre të zhvillohen në vijimësi dhe t’iu përshtaten ndryshimeve gjatë gjithë jetës së tyre profesionale.

## I. PËRMBAJTJA, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë Program të Trajnimit të Vijueshëm Profesional, reflektojnë në mënyrë korrekte kërkesat për implementim të Standarteve 1200 – Aftësia dhe Kujdesi i Duhur Profesional, 1210 – Aftësia dhe 1220 – Kujdesi i duhur profesional, Ligjit nr.114/2015, datë 22.10. 2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”, si dhe në Manulin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *“Të gjithë audituesit e certifikuar në detyrë, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit për auditimin e brendshëm, i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në dy vjet”.*

Si objektivi të përgjithshëm Programi i Trajnimit të Vijueshëm Profesional ka:

*Nxitjen dhe promovimin e vlerave të larta profesionale të audituesve të brendshëm nëpërmjet kulturës së të mësuarit gjatë gjithë jetës.*

Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm synon forcimin e strukturimit të sistemit të edukimit profesional nëpërmjet: certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik si dhe zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve audituese.

Qëllimi i Programit konsiston në zhvillimin e vazhdueshëm të kompetencave profesionale të audituesve të brendshëm, si dhe integritit të këtyre kompetencave në punën audituese për të bërë të mundur të mësuarit në nivel institucional.

Për të arritur këtë, DH/AB do të sigurojë që i gjithë stafi auditues, subjekt i kërkesave ligjore dhe standardeve profesionale, të fitojë aftësi dhe kapacitete profesionale për t’iu përgjigjur kërkesave të këtij ambjenti që ndryshon vazhdimisht.

1210 – Aftësia: Audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë njohuri, aftësi dhe zotësi të tjera të nevojshme, për të përmbushur përgjegjësitë individuale. Aktiviteti i auditimit të brendshëm bashkërisht duhet të zotërojë ose të fitojë njohuritë, aftësitë dhe zotësitë e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë përkatëse.

1210.A1 –Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të sigurojë këshillim kompetent dhe ndihmë nëse audituesit e brendshëm nuk kanë njohuri, aftësi ose zotësi të tjera të nevojshme, për të kryer plotësisht ose pjesërisht angazhimin.

1210.A1 – Audituesit e brendshëm duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për të vlerësuar rrezikun e mashtrimit dhe mënyrën se si drejtohet ky rrezik nga organizata, por nuk pritët të kenë ekspertizën e një personi, përgjegjësia parësore e të cilit është të zbulojë dhe hetojë mashtrimin.

Duke përshtatur të mësuarit, zhvillimin profesional me kërkesat në rritje e në ndryshim të profesionit, Programi i Trajnimit të Vijueshëm ka si qëllim të sigurojë që audituesit e brendshëm përmes përvojës, të zhvillohen profesionalisht në vijimësi, të përdorin teknikat sistematike të përditësuar të zgjidhjes së problemeve dhe të transferojnë njohuritë në mënyrë të shpejtë dhe efikase tek njëri- tjetri (lidhja Teori – Praktikë).

Nëpërmjet këtij programi trajnimi synohet të arrihet forcimi i rolit të auditimit të brendshëm, për të ofruar një shërbim sa më cilësor dhe eficient në njësinë publike ku ai funksionon, qëllim i cili do të përmbushet edhe me përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të audituesve të brendshëm në këtë fushë.

1210. A3 – Audituesit e brendshëm duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për rreziqet dhe kontrollet kyçe të teknologjisë së informacionit dhe teknikat e disponueshme të auditimit të bazuara në teknologji. Megjithatë, jo të gjithë audituesit e brendshëm pritet të kenë ekspertizën e një audituesi të brendshëm, përgjegjësia parësore e të cilit është auditimi i teknologjisë së informacionit.

1210. C1 – Drejtuesi i auditimit të brendshëm nuk duhet të pranojë angazhimin e këshillimit ose të marrë ndihmë dhe këshillim kompetent nëse audituesit e brendshëm nuk kanë njohuritë, aftësitë ose zotësitë e tjera të nevojshme për të kryer plotësisht ose pjesërisht angazhimin.

Respektimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar dhe praktikave më të mira konsiderohen prioritet i rëndësishëm i veprimtarisë audituese dhe sfidë e vazhdueshme e cila rrjedh edhe nga zbatimi i rekomandimeve për zhvillimin e kapaciteteve audituese në sektorin publik të adresuara nga organizma ndërkombëtare.

Në përputhje me sa më sipër, DH/AB ka përcaktuar objektivat e zhvillimit profesional për periudhën të cilat synojnë:

- a) Sigurimin e trajnimeve për audituesit e brendshëm si një qasje e qëndrueshme, e aftë t'í mundësojë stafit ruajtjen dhe rritjen e vazhdueshme të aftësive, dijeve dhe zhvillimin profesional të audituesve.
- b) Inkurajimin e shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencës, në mënyrë që audituesit të kenë akses në praktikat më të mira të fushës së auditimit në sektorin publik dhe zbatimit të tyre në praktikën e punës.

- c) Rritjen e kontributit për menaxhimin efektiv të financave publike duke sjellë shembull të profesionalizmit, integritetit dhe etikës.

Realizimi i këtij programi trajnimi do të mbështesë Objektivat si:

- a) Rritja e cilësisë së performancës së veprimtarisë audituese në funksion të plotësisë të objektivave të përcaktuara për menaxhimin e riskut dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të vendosura në njësinë publike;
- b) Forcimi i rolit të drejtuesit të njësisë së auditimit gjatë kryerjes së çdo angazhim auditimi për respektimin e kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar;
- c) Përditësimi i njohurive të audituesve të brendshëm me dhe pa përvojë, për të kryer një vlerësim real lidhur me efektivitetin e menaxhimit të riskut dhe adresimin e rekomandimeve sa më të vlefshme në respektim të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm;
- d) Njohja e audituesve të brendshëm të njësive publike që zbatojnë projekte të financuara nga programet e Bashkimit Evropian (BE), me zhvillimet e reja për të siguruar një opinion sa më cilësor për efektivitetin e menaxhimit të këtyre fondeve duke vlerësuar zbatimin e ligjshmërisë dhe eficientësinë e përdorimit të tyre në përputhje me rregulloret dhe direktivat e BE.

## **II. METODOLOGJIA E TRAJNIMIT**

Trajnimi do të formulohet dhe organizohet duke u mbështetur në praktikën më të mirë të trajnimit dhe mësimdhënies. Njerëzit janë të ndryshëm, ata mësojnë, marrin informacion dhe komunikojnë në mënyra të ndryshme. Mbi këtë bazë, Programi i Trajnimit përcakton si shumë të rëndësishme metodologjinë e trajnimit.

Ekziston një kuadër i gjerë i metodologjive të trajnimit në thelbin e të cilave qëndron parimi i dhënies formë të trajnimit sipas nevojave dhe mundësive aktuale, duke filluar që nga aplikimi i rasteve studimore apo ndarja e roleve të cilat u mundësojnë pjesëmarrësve të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimit në praktikën e tyre të punës.

Përgjithësisht metodologjia e trajnimit i referohet qasjes së 4 Pyetjeve (4 W), duke ndjekur një rend të paracaktuar të zhvillimit të trajnimit:

- a) Pse – që përcakton arsyen e kryerjes së trajnimit duke nxitur ndërveprimin , motivimin për pjesëmarrje;
- b) Çfarë – duke dhënë informacion dhe që i referohet mësimdhënies;
- c) Si – duke i treguar dhe pyetur se si funksionon në praktikë, në këtë mënyrë pjesëmarrësit kthehen në aktivistë;
- d) Çfarë nëse – duke i mundësuar pjesëmarrësve të vlerësojnë, pra arrijnë në konkluzione dhe njëkohësisht të mendojnë në nivel të së ardhmes.

Duke synuar rritjen e efektivitetit të trajnimeve dhe qasjen e trajnimit të orientuar drejt rezultateve, praktikat kanë treguar se trajnimet me prezantime gradualisht duhet të shoqërohen me teknika të tjera të cilat e bëjnë trajnimin më interaktiv dhe çdo pjesëmarrës të ndjehet palë e barabartë. Gjithashtu, metodat interaktive sigurojnë shkallë më të lartë kontributi të secilit individ dhe informacion të dobishëm për mënyrën e organizimit në të ardhmen.

Programi i trajnimit do të zhvillohet i fokusuar në format e paraqitura më poshtë:

- a) *Nxitja e pjesëmarrjes aktive.*

Prezantimi i temave nëpërmjet transmetimit të njohurive nga trajneri tek audituesit e brendshëm, si dhe zhvillimi i bashkëbisedimit aktiv bazuar në pyetje të cilat nxitin diskutim, vlerësohet si mënyrë efikase për përvetësimin e njohurive të ofruara gjatë fazave të trajnimit.

- b) *Rastet Studimore.*

Zhvillimi i rasteve studimore për temat që do të trajtohen në zbatim të këtij programi vlerësohet si domosdoshmëri për të motivuar audituesit që të jenë pjesëmarrës aktivë dhe të shprehin opinionin e tyre apo të japin zgjidhje për situatat konkrete dhe hipotetike të prezantuara.

- c) *Materialet e përgatitura për t'u prezantuar në trajnim.*

Përzgjedhja e kujdesshme e informacionit, si dhe hartimi i prezantimeve të përshtatshme për trajnim vlerësohet si faktorë i rëndësishëm në suksesin e trajnimit. Informacioni i prezantuar do të jetë plotësim i njohurive që ju shërbejnë audituesve pjesëmarrës jo vetëm gjatë trajnimit, por edhe në rastet kur është domosdoshmëri aplikimi i këtyre njohurive në praktik.

Trajnimi i konceptuar të kryhet duke aplikuar punën në grup për trajtimin e rasteve studimore të hartuara nga trajnerët lektor i jep hapësirë të gjerë diskutimit të problematikave të rëndësishme të



prezantuara nga vetë audituesit pjesëmarrës, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet kolegësh dhe ofruar zgjidhje të larmishme të situatave specifike.

Në programin e trajnimit të vijueshëm profesional 2020 informacioni që do të përcillet lidhet me:

- a) auditimin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit afatmesëm;
- b) kontabilitetin publik si një element i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm në njësitë publike;
- c) sigurimin e cilësisë së veprimtarisë audituese dhe programin e përmirësimit;
- d) identifikimin e faktorëve të riskut, vlerësimin e tre dhe masat për përmirësimin e administrimit të risqeve dhe proceseve të kontrollit;
- e) procedurat e prokurimit të fondeve publike sipas kufijve monetar të përcaktuar etj.

### III. VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIM

Në përgatitjen e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm janë konsideruar :

- a) **Identifikimi** i nevojave:
  - 1. Kush ka nevojë të trajnohet; dhe
  - 2. Çfarë trajnimesh janë të nevojshme.
- b) **Vendosja e prioriteteve** për plotësimin e nevojave të identifikuara.
- c) **Monitorimi dhe vlerësimi** i zbatimit të Programit dhe vlerësimi i performancës së trajnimit.

Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm duke e vlerësuar aftësimin profesional të stafit drejtues dhe auditues si faktor të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të shërbimit të auditimit në njësitë publike në program i ka kushtuar hapësirë të veçantë përmbushjes së nevojave për trajnim të identifikuara nga vetë njësitë e auditimit të brendshëm.

Identifikimi i këtyre kërkesave për trajnim është bërë nëpërmjet shqyrtimit të:

- a) tematikave të sugjeruara në formatin standard të planit vjetor të konsoliduar, në të cilin përcaktohen tematikat e kërkuara nga çdo njësi e auditimit të brendshëm;
- b) tematikave të sugjeruara në formularin e vlerësimit plotësuar nga të gjithë audituesit e brendshëm gjatë trajnimit të vijueshëm profesional 2019;

- c) vlerësimeve të jashtme për veprimtarinë audiuese të kryera nga DH/AB gjatë vitit 2019;
- d) rekomandimeve të adresuara nga organizma ndërkombëtare për zhvillimin e kapaciteteve audituese në sektorin publik;
- e) propozimeve konkrete në workshop-ët e organizuar për fushat në të cilat është e domosdoshme të përditësohen e plotësohen njohuritë.

### ***Tematika e Trajnimit***

Në përfundim të procesit të identifikimit dhe analizës së nevojave për trajnim të audituesve të brendshëm në detyrë në Njësitë e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, temat që kërkojnë vëmendje dhe për t'u vendosur në prioritet të Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për vitin 2020 përfshijnë :

#### **Tema të identifikuara për t'u përfshirë në Programin e Trajnimit**

- a) Auditimi i menaxhimit të shpenzimeve publike në njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- b) Kontabiliteti publik si një element i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm;
- c) Sigurimi i cilësisë dhe Programi i përmirësimit;
- d) Auditimi i prokurimit të fondeve publike;
- e) Siguria e informacionit, lidhja me parimet standardet, si dhe kërkesa të tjera në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar;
- f) Auditimi i fondeve nga projektet e BE dhe donatorëve të huaj (Fondet IPA).

Programi do të ketë në përmbajtje të tij tema që trasmentojnë informacion dhe risi në fusha që kanë lidhje me:

- a) Trajtimin e ciklit të menaxhimit të shpenzimeve publike, duke prezantuar etapat e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) proceset, rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në të bazuar në shpjegimin e parimeve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin parësor dhe dytësor të menaxhimit të sistemit buxhetor shqiptar.

Prezantimi i PBA-së si instrument për harmonizimin e buxhetit me politikat sektoriale të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), përfaqëson një prej arritjeve

më të rëndësishme të reformës së Financave Publike dhe në këtë kuptim hartimi i këtij dokumenti sa më realist, cilësor dhe të qëndrueshëm ndihmon në realizimin e politikave strategjike të zhvillimit të vendit.

Në këto kushte, përditësimi i njohurive të audituesve të brendshëm lidhur me metodologjinë e përgatitjes së PBA-së, proceset e punës në fazat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit do të përmirësojë cilësinë e angazhim auditimeve që do të kryhen në këtë fushë, si dhe cilësinë e rekomandimeve që do të adresohen.

- b) Njohjen e rolit të organizmave rregullatorë dhe këshillimorë në fushën e kontabilitetit, burimet e autoritetit të raportimit financiar ndërkombëtar, si dhe përdorimin e tij në botë, sigurimin e një evidence të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të konfirmuar se:
1. njësia publike vlerëson me prioritet risqet kundrejt kriterëve për pranimin e riskut,
  2. menaxhimi mbështet politikat e sigurisë së informacionit në përputhje me kriteret e proceseve të veprimtarisë për të përcaktuar nëse kategoritë kryesore të sigurisë janë adresuar.
- c) Identifikimin e faktorëve të riskut, vlerësimi i risqeve nga audituesit e brendshëm si në fazën e planifikimit strategjik e vjetor ashtu dhe gjatë hartimit të programit të angazhim auditimit. Kontributi për të adresuar përmirësime të rëndësishme në proceset e qeverisjes së veprimtarisë në njësinë publike, nëpërmjet mbajtjes së risqeve në nivele të pranuar dhe përcaktimit të proceseve të kontrollit.
- d) Kryerjen e procedurave të prokurimit sipas fazave kryesore të përcaktuara në kuadrin rregullator të fushës bazuar në kufijtë monetarë të specifikuar.

Prezantimi i temave të parashikuara në program do të kryhet nga trajnerët e miratuar nga Komisioni i Kualifikimit të audituesve të brendshëm, të cilët sipas kriterëve të përzgjedhjes zotërojnë njohuritë dhe eksperiencën që do t'i ndihmojë në sqarimin e rasteve, situatave apo pyetjeve konkrete që do të drejtojnë pjesëmarrësit në trajnim.

#### IV. VLERËSIMI I BURIMEVE TË TRAJNIMIT

Individët mësojnë më shumë kur ata përfshihen në mënyrë aktive në procesin e trajnimit. Zhvillimi i kapaciteteve individuale çon në rritjen e kapaciteteve të vetë institucioneve, çka do të thotë dhe zhvillim në tërësi për shoqërinë.

Për këtë qëllim gjatë planifikimit të trajnimit çështjet kryesore që janë mbajtur në konsideratë janë si më poshtë:

- a) Të punohet në mënyrë të vazhdueshme për të përshtatur kërkesat e individëve me objektivat e zhvillimit të institucionit po ashtu dhe qeverisjes në përgjithësi.
- b) Vendosja e objektivave të qarta të trajnimit. Kjo ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë pritshmëritë e tyre në drejtim të njohjes, si dhe përcaktimit të metodave dhe mjeteve të trajnimit. Për më tepër, kjo do të ndikojë në vlerësimin e performancës së trajnerëve dhe vetë procesit të trajnimit.
- c) Siguria që çdo trajnim ka në qendër eksperiencën dhe njohuritë e pjesëmarrësve. Trajnimet duhet të projektohen të tilla që të maksimizojnë ndërveprimin midis teorisë dhe praktikës, po ashtu dhe midis vetë pjesëmarrësve.
- d) Përfshirjen e feedback-ut të pjesëmarrësve gjatë gjithë procesit: para, gjatë dhe pas trajnimit.

##### ***Grupet e synuara***

Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm në detyrë në sektorin publik (të rinj apo me eksperiencë), i përcaktuar si detyrim ligjor ka për qëllim përditësimin e njohurive për ndryshimet në kuadrin rregullator dhe njohjen me risitë në fushën e auditimit të brendshëm.

Në trajnim planifikohet të jenë pjesëmarrës rreth 350 auditues të brendshëm në detyrë, (bazuar në të dhënat e analizuara në planin vjetor të konsoliduar të auditimit të brendshëm për vitin 2020).

Programi i trajnimit është parashikuar të zhvillohet në 40 orë trajnimi, për secilin auditues të brendshëm të certifikuar në detyrë, sipas grupeve të përcaktuara në kalendarin e shpërndarjes së pjesëmarrësve në trajnim pjesë integrale e këtij programi.

Modulet e trajnimit përmbajnë tema të konceptura në përshtatje me:

- a) Pozicionin e punës në njësinë e auditimit (drejtues, auditues i brendshëm);
- b) Eksperiencën që zotërojnë në fushën e auditimit të brendshëm, pavarësisht sezonit në të cilin janë pajisur me titullin “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

## KATEGORITË E GRUPEVE TË TRAJNIMIT

Programi i trajnimit, është konceptuar në tre module për secilin grup pjesëmarrës, si më poshtë:

- a) Moduli I Drejtues dhe auditues të brendshëm të njërive të auditimit të brendshëm në ministri, institucione qendrore dhe vendore, rreth **235 pjesëmarrës**;
- b) Moduli II Auditues të brendshëm të njërive të auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes qendrore e vendore të certifikuar ne vitet e fundit, rreth **82 pjesëmarrës**;
- c) Moduli III. Auditues të brendshëm të punësuar në institucionet përfituese të fondeve IPA rreth **22 pjesëmarrës**.

## CIKLI DHE DREJTUESIT E TRAJNIMIT

Programi i Trajnimit përfshin periudhën vjetore 2020, gjatë të cilës parashikohet të mbulohen me trajnime të gjitha kërkesat e nevojat e përcaktuara në procesin e Analizës së Nevojave për Trajnim.

Cikli i trajnimit synon të sigurojë, të ofrojë trajnime të përshtatshme, në kohë dhe me cilësi të lartë nga ekspertë të fushës së auditimit. Ai përfshin një model të qëndrueshëm për të kuptuar dhe vlerësuar nevojat për trajnim dhe për të hartuar dhe ofruar mbi këtë bazë, trajnime që përfshijnë metoda të përparura, praktike dhe të përshtatshme për audituesit e brendshëm.

Organizimi dhe formatimi i trajnimeve janë konceptuar që t'i japin mundësinë çdo audituesi të brendshëm të marrë pjesë në jo më pak se **40 orë trajnimi gjatë vitit**.

Synimi për të siguruar cilësi të lartë në trajnim ka shtuar përpjekjet për të përfshirë trajnues/lektorë me profil të lartë profesional dhe integritet në fushën akademike dhe profesionale.

Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në përshtatje me temat e miratuara në Programin e trajnimit do të përzgjedhë trajnerët që do të prezantojnë informacionin në çdo fazë trajnimi.

Trajnerët lektorë që përzgjidhen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 13, të Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhër nr.3, datë 8.01.2016 të Ministrit të Financave, po kështu dhe materialet e trajnimit do të marrin miratimin e Komisionit përpara fillimit të procesit.

Nëpërmjet shembujve praktik apo rasteve studimore trajnerët do të duhet të nxitin pjesëmarrjen aktive në bashkëbisedim dhe ndërveprimin e audituesve të brendshëm për arritjen e objektivave të vendosura për secilin modul.

## **VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PROCESIT TË TRAJNIMIT**

Në përfundim të çdo trajnimi, feedback-u/informacioni nga pjesëmarrësit do të sigurohet nëpërmjet një “Formulari të Vlerësimit të Trajnimit”, i cili do të shërbejë si bazë për rishikimin e Programit të Trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve sa më të përshtatshme dhe të cilësisë së lartë për stafin si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Vlerësimi i performancës së Trajnimit do të përfshijë: vlerësimin e performancës dhe nivelit të trajnuesit/lektorit, metodat dhe format e trajnimit, përmbajtja dhe përshtatshmëria e tematikave të përzgjedhura, lehtësirat dhe mjaftueshmëria e materialeve të trajnimit etj.

Qëllimi i vlerësimeve lidhet me “vlerën e shtuar” në trajnim e përcaktohet si rritja që stafi i trajnuar arrin (njohuritë, aftësitë dhe cilësi të tjera), si rezultat i trajnimit të tyre në nivele më të larta. Vlera e shtuar i referohet çfarë vlere akumulon audituesi si rezultat i trajnimit brenda një periudhe kohe të caktuar.

Me mbarimin e trajnimit, audituesit pjesëmarrës pajisen me “Vërtetim për pjesëmarrje” nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, si dhe evidentohen në rregjistrin përkatës të audituesve të brendshëm.

## **MONITORIMI**

Monitorimi i implementimit të Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional konsiderohet shumë i rëndësishëm për procesin e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm, pasi ofron informacion të vlefshëm dhe në kohë për t’u siguruar se veprimtaritë po kryhen sikurse ishin parashikuar në këtë Program dhe ndihmon që veprimet korrigjuese të ndërmerren në kohë dhe po ecet në drejtim të plotësisht të objektivave.

Drejtorja e Harmonizimit për AB monitoron në mënyrë të vazhdueshme implementimin e Programit të miratuar. Ajo raporton në mënyrë periodike dhe sa herë që është e nevojshme dhe kërkohet tek Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm si dhe strukturat e tjera drejtuese në sektorin publik sipas kërkesave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe mbështetës përkatësisht.

## PROGRAMI VJETOR SIPAS MODULEVE TË TRAJNIMIT

### MODULI I PARË I TRAJNIMIT:

**Pjesëmarrësit:** *Drejtues dhe auditues të brendshëm të njësisë të auditimit të brendshëm në ministri dhe institucione qendrore e vendore mbi tre vite eksperiencë.*

**Objektivat e trajnimit:** Sigurimin e cilësisë në nivel të lartë për shërbimin e auditimit të brendshëm, rritjen e nivelit të performancës së njësisë së auditimit të brendshëm, nëpërmjet planifikimit, kryerjes së angazhim auditimeve, raportimit të rezultateve dhe monitorimit të progresit të përmirësimeve të rekomanduara duke respektuar kërkesat e përcaktuara në standardet ndërkombëtare të auditimit të pranuar.

Në përfundim të këtij programi trajnimi, drejtuesit e njësive të auditimit do të mund të:

- a) konceptojnë më mirë fazat e hartimit dhe zbatimit të pagesave nga njësitet publike ku ofrojnë shërbimin e auditimit;
- b) kenë vizion më të qartë për procesin të zbatimit dhe monitorimit të projekt buxhetit afatmesëm;
- c) kenë njohuri të plota lidhur me kontabilitetin publik si element i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm;
- d) kenë njohuri lidhur me procedurat e prokurimit të fondeve publike, autoritetin dhe përzgjedhjen e kontratës;
- e) zbatojnë procedurat e auditimit bazuar në risk duke konsideruar edhe riskun për mashtrim.

### PROGRAMI I TRAJNIMIT - MODULI I

*Drejtues dhe auditues të brendshëm në njësitet e auditimit në ministri, institucione qendrore dhe vendore*

**Dita I**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema I. Auditimi i menaxhimit të shpenzimeve publike në njësitet e qeverisjes së përgjithshme.**

- a) *Kuadri rregullator i hartimit dhe zbatimit të strukturave organike dhe të sistemit të pagave nga NJQP (gjurma e auditimit);*
- b) *Auditimi i procesit të hartimit të PBA;*
- c) *Auditimi i procesit të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit afatmesëm (gjurma e auditimit);*

**Dita II****(4 orë + 4 orë)****Tema II. Kontabiliteti publik si një element i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm.**

- a) *Roli i informacionit kontabël dhe rregullat e regjistrimit;*
- b) *Veçoritë e kontabilitetit në sektorin publik;*
- c) *Kuadri rregullator aktual i kontabilitetit të sektorit publik në vendin tonë (Udhëzimi nr. 8 dhe udhëzimi nr. 30);*
- d) *IPSAS – perspektiva e kontabilitetit të sektorit publik;*
- e) *Auditimi i raportimit financiar (gjurma e auditimit).*

**Dita III****(4 orë + 4 orë)****Tema III. Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit.**

- a) *Kërkesat e programit të siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë;*
- b) *Vlerësimet e brendshme;*
- c) *Vlerësimet e jashtme;*

**Dita IV****(4 orë + 4 orë)****Tema IV Auditimi mbi bazë riskun dhe risku i mashtrimit.**

- a) *Faktorët e riskut, vlerësimi i risqeve gjatë planit strategjik e vjetor, si dhe gjatë hartimit të programit të angazhim auditimit;*
- b) *Përmirësimi i administrimit të risqeve dhe proceseve të kontrollit në funksion të efikasitetit të proceseve të qeverisjes së veprimtarisë së njësisë publike;*
- c) *Vlerësimi i riskut për mashtrim, përgjegjësia për mashtrimet në njësinë publike;*
- d) *Parandalimi i riskut për mashtrim nga auditimi i brendshëm.*

**Dita V****(4 orë + 4 orë)****Tema V. Auditimi i prokurimit të fondeve publike**

- a) *Fazat kryesore të prokurimit publik;*
- b) *Procedurat e prokurimit (kufijtë monetarë);*
- c) *Autoriteti kontraktor dhe përzgjedhja e kontratës.*



## MODULI I DYTË I TRAJNIMIT:

**Pjesëmarrësit:** *Auditues të brendshëm të njërive të auditimit në ministri dhe institucione qendrore e vendore të certifikuar tre sezonet e fundit.*

**Objektivat e trajnimit:** Përditësimi i njohurive për audituesit e brendshëm me përvojë dhe atyre me më pak përvojë lidhur me garantimin e cilësisë në të gjitha fazat e kryerjes së angazhim auditimeve. Forcimin e rolit të auditimit të brendshëm në procesin e vlerësimit të efektivitetit të menaxhimit të riskut, në funksion të arritjes së objektivave të njësisë publike, nëpërmjet adresimit të rekomandimeve në raportet e hartuara, si dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit të pranuar.

Në përfundim të këtij cikli trajnimi audituesit e brendshëm do të mund të:

- a) konceptojnë më mirë fazat e hartimit dhe zbatimit të pagesave nga njësisë publike ku ofrojnë shëbimin e auditimit;
- b) kenë vizion më të qartë për procesin e hartimit dhe zbatimit të projekt buxhetit afatmesëm;
- c) kenë njohuri të plota lidhur me kontabilitetin publik si element i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm;
- d) qartësojnë konceptin e sigurimit të cilësisë së veprimtarisë audituese dhe kërkesave të përmirësimit të cilësisë;
- e) njihen me organizimin e dokumentimin e politikave të sigurisë së informacionit dhe menaxhimin e komunikimit dhe operacioneve.

### PROGRAMI I TRAJNIMIT - MODULI II

*Auditues të brendshëm në njësitë e auditimit në ministri, institucione qendrore dhe vendore të certifikuar tre sezonet e fundit*

**Dita I**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema I. Auditimi i menaxhimit të shpenzimeve publike në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.**

- a) *Kuadri rregullator i hartimit dhe zbatimit të strukturave organike dhe të sistemit të pagave nga NJQP (gjurma e auditimit);*

- b) *Auditimi i procesit të hartimit të PBA;*
- c) *Auditimi i procesit të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit afatmesëm (gjurma e auditimit);*

**Dita II**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema II. Kontabiliteti publik si një element i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm.**

- a) *Roli i informacionit kontabël dhe rregullat e regjistrimit;*
- b) *Veçoritë e kontabilitetit në sektorin publik;*
- c) *Kuadri rregullator aktual i kontabilitetit të sektorit publik në vendin tonë (Udhëzimi nr. 8 dhe udhëzimi nr. 30);*
- d) *IPSAS – perspektiva e kontabilitetit të sektorit publik;*
- e) *Auditimi i raportimit financiar (gjurma e auditimit).*

**Dita III**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema III. Siguria e informacionit, lidhja me parimet standardet, si dhe kërkesa të tjera në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar.**

- a) *Dokumentimi i politikave të sigurisë së informacionit;*
- b) *Organizimi i sigurisë së informacionit;*
- c) *Menaxhimi i komunikimit dhe operacioneve;*
- d) *Incidentet e sigurisë së informacionit.*

**Dita IV**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema IV Auditimi mbi bazë riskun dhe risku i mashtrimit.**

- a) *Faktorët e riskut, vlerësimi i risqeve gjatë planit strategjik e vjetor, si dhe gjatë hartimit të programit të angazhim auditimit;*
- b) *Përmirësimi i administrimit të risqeve dhe proceseve të kontrollit në funksion të efikasitetit të proceseve të qeverisjes së veprimtarisë së njësisë publike;*
- c) *Vlerësimi i riskut për mashtrim, përgjegjësia për mashtrimet në njësinë publike;*
- d) *Parandalimi i riskut për mashtrim nga auditimi i brendshëm.*

**Dita V**

**(4 orë + 4 orë)**

**Tema V Auditimi i prokurimeve publike.**

- a) *Fazat kryesore të prokurimit publik;*

- b) *Procedurat e prokurimit (kufijtë monetarë);*
- c) *Autoriteti kontraktor dhe përzgjedhja e kontratës.*

## **MODULI I TRETË I TRAJNIMIT:**

**Pjesëmarrësit:**     *Auditues të brendshëm në institucionet përfituese të fondeve IPA*

**Objektivat e trajnimit:** Njohja e audituesve të njësive të auditimit të brendshëm që auditojnë projekte të financuara nga programet e Bashkimit Evropian (BE) me risitë e bazës ligjore e rregullative të fushës me qëllim rritjen e efektivitetit të menaxhimit të fondeve nëpërmjet vlerësimit të ligjshmërisë dhe efektivitetit të përdorimit të tyre në përputhje me rregulloret dhe direktivat e BE-së.

Në përfundim të këtij programi trajnimi audituesit e brendshëm do të mund të:

- a) njohin panoramën e përgjithshme të sistemit të menaxhimit të fondeve të asistencës së BE për vendet paraanëtarësimit (IPA);
- b) njohin strukturat dhe rregullat e menaxhimit, si dhe të ofrojë njohuri mbi qasjen e audituesve në angazhimet e auditimit të këtyre fondeve;
- c) kenë kuptim të qartë lidhur me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit që aplikohen gjatë auditimit të fondeve të BE-së;

### **PROGRAMI I TRAJNIMIT - MODULI III**

*Auditues të brendshëm në njësitë e auditimit të institucioneve përfituese të fondeve IPA*

**Dita I** **(4 orë + 4 orë)**

**Tema I. Kuadri ligjor i asistencës së BE-së për financimin e projekteve.**

- a) *Rregulloret e KE-së, Direktivat;*
- b) *Marrëveshjet Kuadër.*
- c) *Marrëveshjet sektoriale dhe operacionale;*
- d) *Akte të tjera nënligjore dhe Manuallet.*

**Dita II** **(4 orë + 4 orë)**

**Tema II. Sistemi i menaxhimit të fondeve të asistencës (Strukturat dhe funksionet e strukturave të IPA).**

- a) *Menaxhimi financiar dhe kontrolli;*
- b) *Struktura, funksionet dhe përgjegjësitë.*

### **Dita III**

**(4 orë + 4 orë)**

#### **Tema III. Çfarë përfshin auditimi i fondeve të asistencës së BE-së.**

- a) *Objektivat dhe fushëveprimi;*
- b) *Qëllimi i auditimit të fondeve të BE-së;*
- c) *Forma te raportimit dhe struktura e raportit .*

### **Dita IV**

**(4 orë + 4 orë)**

#### **Tema IV. Njohja me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit të aplikueshme në auditimin e fondeve të BE- së.**

- a) *Standardet e INTOSAI-it;*
- b) *Standardet IIA.*

### **Dita V**

**(4 orë + 4 orë)**

#### **Tema V. Njohja dhe kuptimi i qasjes së përgjithshme të auditimit, hapat dhe procedurat që ndiqen.**

- a) *Llojet e auditimit;*
- b) *Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i Auditimit;*
- c) *Vlerësimi i riskut dhe materialiteti;*
- d) *Kryerja e auditimit (Programi i Angazhimit te Auditimit- Puna në Terren- Dokumentimi i punës audituese, Vlerësimi Evidencës dhe Raportimi);*
- e) *Vlerësimi i keqdeklarimeve, gabimeve dhe raportimi në KE (DG përkatëse);*
- f) *Ndjekja e raportit dhe rekomandimeve të auditimit;*
- g) *sigurimi i cilësisë.*

### **Numri maksimal i pjesëmarrësve**

Pjesëmarrës në këtë trajnim do të jenë rreth 350 auditues të brendshëm në detyrë, (sipas të dhënave të planit të konsoliduar të auditimit të brendshëm për vitin 2020), të ndarë në grupe trajnimi, sipas pozicionit përkatës të punës në njësitë e auditimit të brendshëm të njësive publike.

### **Ngarkesa e orëve**

Programi i këtij cikli trajnimi është parashikuar të zhvillohet në 40 orë trajnimi në total, për secilin auditues të certifikuar në detyrë, sipas grupeve të synuara. Programi do të zhvillohet sipas kalendarit përkatës të shpërndarjes së pjesëmarrësve në trajnim.

*Konceptoi:* I. Dervishi  
*Konfirmoi:* A. Gjinopulli  
*Miratoi:* K. Halili